


NE JEMI PËR JU



JU JENI PËR NE

NE I SHPREHIM MENDIMET TONA

ENDRIT (12), LEON (12), FJOLLA (12), ERDONIT (12), TRËNDËLINA (12), ERDON (12), GENTRIT (13),
VJOLLCA (12), EGZON (12)



Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Në këtë artikull është shkruar se si është një vend pa demokraci dhe se si është një vend demokratik. Lexojeni që ta kuptoni edhe ju

Në një vend të largët, shumë njerëz nuk e kishin të drejtën e shprehjes së mendimit. Ata nuk ndjeheshin aspak mirë, sepse shumë ide që i kishin nuk mund t'i tregonin. Pastaj, edhe për t'u shkolluar nuk kishin të drejtë të gjithë, por vetëm ata të cilët ishin më të pasur. Vendi nuk zhvillohej si duhej dhe shumë prej njerëzve diskriminoheshin. Udhëheqësi i vendit, po ashtu, merrte vendime pa u konsultuar me popullin e tij. Ai nuk i merrte parasysh fare kërkesat e tyre. Ndërsa, vendi fqinj ishte vend demokratik. Aty kishte liri dhe barazi. Ligjet të cilat janë rregulla që duhen zbatuar, iu garantonin atyre të drejtat e barabarta, si:

të drejtën e shkollimit, të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit, të drejtën e vendimmarrjes, etj. Pra, dallonte shumë nga vendi ku nuk kishte demokraci. Populli në demokraci merr vendime, duke i votuar përfundimisht, të cilat pastaj merrnin vendime të rëndësishme për vendin e tyre. Ky ishte një shembull se si do të ishte jeta jonë po të mos jetonim në një vend demokratik. Në demokraci edhe pse ka diversitet apo llojllojshmëri mendimesh, të drejtat e barabarta i kanë të gjithë pa dallim gjinie, race, etniciteti, moshe, etj. Përveç këtyre të mirave që na sjell demokracia, ne si qytetarë duhet të jemi të përgjegjshëm, si dhe ne duhet t'i kryejmë detyrat tona ndaj shtetit ku jetojmë. E kemi një mesazh për ju të dashur lexues: të mësojmë dhe të punojmë sa më shumë, në mënyrë që e ardhmja jonë të jetë e zhvilluar.



Gazetarët e ardhshëm



Bashkëpunimi sjell një të ardhme të ndritur

KUVENDI NË JETËN TONË

ERION (12), LEUTRIM (12), YLL (13), ALBIN (13), RILIND (12), ENSARA (12), ERMIRA (13), LEONA (13)



Kuvendi dhe rëndësia e këtij institucioni në jetën tonë si qytetarë

Qytetarë të dashur, a e dini se ekziston një ligj, i cili thotë se në rast të fatkeqësive natyrore, institucionet publike duhet të mobilizohen për të mbrojtur qytetarët? Ky ligj është në dobi të të gjithë neve kosovarëve. Jo vetëm ky ligj, por të gjitha ligjet që janë në fuqi, janë në dobinë tonë si qytetarë. E vendi prej nga


sion tjetër i Kuvendit është funksioni kontrollues. Kjo sepse Kuvendi përpos që e voton Qeverinë, ai edhe e kontrollon punën e saj. Si dhe funksioni i tretë është funksioni përfaqësues, sepse siç e dijme, deputetët janë përfaqësuesit tanë në Kuvend. Deputetët mbajnë mbledhje, të cilat njihen si seanca plenare. Në këto mbledhje diskutohen probleme të ndryshme me të cilat ballafaqohen qytetarët. Ata mundohen t'i zgjidhin këto probleme, përmes diskutimeve dhe miratimit të ligjeve. Ne si qytetarë i zgjedhim përfaqësuesit tanë me votave tona. Çdo vendim i tyre ndikon në jetën e gjithë neve. Prandaj, deputetët janë kaq të rëndësishëm për ne. Pas pak, do të shkojmë të vizitojmë Kuvendin e Kosovës. Jemi duke pritur me padurim këtë vizitë. Sof, përpos që e kuptuam rëndësinë e këtij institucioni, do ta shohim edhe për nga afër institucionin magjik, i cili e rregullon jetën e të gjithë qytetarëve pa asnjë dallim të mundshëm.



miratohen këto ligje është institucioni më demokratik i vendit. Ky institucion është Kuvendi i Kosovës, që ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“. Po përse kështu vallë? Përgjigjja e kësaj pyetje është shumë e thjeshtë. Deputetët, të cilët punojnë në Kuvend janë të zgjedhur pikërisht nga ne populli. Ata me numër janë 120 dhe flasin në emrin tonë. Marrin vendime dhe miratojnë ligje në emrin tonë. Kjo detyrë apo funksion i Kuvendit, njihet ndryshe si funksioni legjislativ. Funk-




Ne jemi e ardhmja e vendit




Të gjithë i kemi të drejtat e barabarta në demokraci.
Liri dhe paqe, dy fjalë me peshë të madhe




Qytetarët aktiv mund të paraqesin kërkesat e tyre me anë të
peticioneve, duke i nënshkruar ato



Vota e secilit ka vlerën e saj, sepse ndryshimi vjen pikërisht
duke votuar në procesin zgjedhor



Sikur Dielli që me rrezet e tij e ndriçon dhe e ngrohë Tokën,
ashtu edhe ne duke punuar e ndriçojmë vendin tonë




Me anë të medias, qytetarët informohen për ngjarjet që
ndodhin kudo në botë



Prej shumë të drejtave që çdo qytetar i ka në demokraci, në
këtë vizatim është paraqitur e drejta e kujdesit shëndetësor



Nëse një ligj shkelet, atëherë gjykatat merren me vendosjen
e drejtësisë



Duke pasur të drejtën e shprehjes së mendimit, ne mund të
japim ide të ndryshme për shumë gjëra


MIRATIMI, EKZEKUTIMI DHE DREJTËSIA

BLEND (13), GENT (12), DRITON (12), ALBION (12), LIRIM (12), ALBIN (12), YLLKA (12), VLERA (12)



Përshëndetje për juve. Ne sot kemi mësuar për Ndarjen e Pushtetit. Jemi kënaqur aq shumë duke mësuar për këtë temë, sa që kemi vendosur të shkruajmë këtë artikull në mënyrë që t'ua tregojmë edhe juve disa fakte

Sot kemi mësuar për Ndarjen e Pushtetit. Por, kush e ka pushtetin në demokraci? Në demokraci pushtetin e ka populli, që do të thotë ne, qytetarët e Kosovës. Pasi që jemi një shtet demokratik i ri, ne kemi nevojë të mësojmë për gjëra të tilla. Ndër gjërat e para që na



shkoi ndërmend sot, ishte kjo pyetje: „Si e shprehin qytetarët pushtetin që ata kanë?“ Në këtë pyetje përgjigjemi ne. Ne realizojmë pushtetin tonë me anën e votave. Duke votuar ne i zgjedhim deputetët, kryetarët e komunave dhe asamblistët komunal. Deputetët punojnë në Kuvendin e Kosovës. Pasi marrin këtë rol, ata kanë nevojë për një person, i cili udhëheq takimet në mes tyre. Ai është Kryetari i Kuvendit. Gjithashtu, deputetët kanë për detyrë të zgjedhin Qeverinë. Qeveria

përbëhet nga Kryeministri, ministrat dhe zv. ministrat. Këto janë dy nga institucionet më të rëndësishme në shtetin tonë. Vendet demokratike, për të qenë me të vërtetë të tilla, duhet të kenë një institucion i cili kujdeset që të gjithë qytetarët të trajtohen në mënyrë të barabartë, të jenë të sigurtë në shtetin e tyre, si dhe të sigurohet se rregullat e vëna shtetërore po zbatohen nga të gjithë. Ky institucion është gjykata. Tri institucionet e përmendura janë edhe tri degët e pushtetit. Kuvendi bën pjesë në degën e legjislativit, sepse miraton ligjet. Qeveria bën pjesë në degën e ekzekutivit, sepse i kthen ato ligje në vepra. Gjykata përfaqëson degën e gjyqësorit, sepse vë drejtësi në vend. Kjo është e njëjtë si kompozitori i veprave muzikore i cili shkruan notat në pentagram. Mirëpo, për t'u dëgjuar kjo muzikë duhet të ekzekutohet nga një instrumentist i mirë. Kështu tingujt e saj dëgjohen edhe nga ne. Ndërsa ne, mund të zgjedhim se cilën muzikë mund ta dëgjojmë, sepse ne e kemi këtë të drejtë.



Të rinjë, gazetarë dhe fantastikë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dy Dëshmorët“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Dobrajë e Madhe, Lipjan